


RREGULLAT PËR DHËNIEN E PROVIMEVE EKSTERNE



TË NDERUAR MATURANTË, LEXONI ME VËMENDJE RREGULLAT PËR DHËNIEN E PROVIMEVE EKSTERNE TË MATURËS SHETËRORE.

NË DITËN E PROVIMIT JU DUHET:

- të jeni në shkollë në ora 9:30;
- të merrni me vete një dokument për identifikimin personal me fotografi (letërnjoftim, patent shoferi ose librezë nxënësi me fotografi dhe vulë të shkollës amë);
- t'i lini anash të gjitha gjësendet personale (çanta, celularë dhe pod-mjete, organajzerë, kalkulatorë) në vendin e paraparë për to;
- të kontrolloni rregullshmërinë e testit në kohën e paraparë për përgatitjen e provimit – 15 minutat e para (nga ora 10.00 deri në ora 10.15);
- t'i lexoni udhëzimet për zgjidhjen e testit, të cilat gjenden në faqen e parë të testit dhe në fletën apo listën e përgjigjeve.

JU LEJOHET:

- të konsumoni ujë ose pije joalkoolike;
- të përdorni mjete shkrimi (stilograf me ngjyrë të kaltërt)-**Përgjigjet e dhëna me laps nuk vlersohen;**
- të përdorni vegla për gjeometri (vizore, kompas, laps dhe gomë)- jo patjetër;

NUK JU LEJOHET:

- të shfrytëzoni letër, celular, kalkulator ose lloje tjera të mjeteve elektronike;
- të konsultoheni dhe të merreni vesh me kandidatët tjerë;
- të kopjoni nga tjetri ose të lejonin të kopjojnë nga ju;
- të silleni keq ndaj organizatorëve të provimeve ose ndaj kandidatëve tjerë;
- të shënoni shenja apo përmbajtje të pahijshme në test apo në fletën e përgjigjeve;
- të shënoni shenja apo përmbajtje që orientojnë ndaj identitetit të kandidatit;
- të mos e dorëzoni të gjithë apo një pjesë të materialit testues.

Masat të cilat i shqipton testatori/mbikqyrësi gjatë shkeljes së rregullave për dhënie e provimeve të maturës shtetërore:

 VËREJTJE, jepet kur kandidati:	- posedon mjete të cilat nuk lejohen dhe që nuk janë të parapara me programin e provimit (letër, celular etj.); - shënon shenja të dyshimta në test ose në listën e përgjigjeve; - këmben informata që kanë të bëjnë me provimin.
 NDËRPRERJA E PROVIMIT, bëhet kur kandidati:	- pas vërejtjes së bërë vazhdon ti përsërisë gabimet ose shkeljet e rregullave; - kopjon nga kandidati tjetër; - lejon të kopjojnë prej tij.